

# Funksionimi i lojërave shpërblyese në Kosovë në mungesë të kontrollit ligjor



Funksionimi i lojërave  
shpërblyese në Kosovë në  
mungesë të kontrollit ligjor

Mars 2024

— **Përmbajtja**

Përmbledhje ekzekutive	3
Hyrje	4
(Mos)kontrolli i lojërave shpërblyese në Kosovë	5
Lojërat shpërblyese në Kosovë: llogaritjet e shpërblimeve	6
Praktikat e shpërblimit të klientëve në vendet e Bashkimit Evropian dhe Ballkanit Perëndimor	8
Përfundime dhe rekomandime	11
Shtojcat	12

**Deklaratë mohimi:**

Ky raport është mundësuar me mbështetjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP përmes projektit Mbështetje në Përpjekjet Kundër-Korrupsionit në Kosovë (SAEK) III, financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA), për të promovuar transparencën institucionale dhe buxhetore dhe llogaridhënien. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Institutit GAP dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e UNDP-së në Kosovë, SDC-së dhe SIDA-së.

Mbështetur nga:



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo



Sweden  
Sverige

## Përmbledhje ekzekutive

Aktualisht, bizneset në Kosovë organizojnë lojëra të ndryshme shpërblyese, e të cilat nuk monitorohen nga ndonjë institucion shtetëror. Përmes këtyre lojërave, ku klientët mund të përfitojnë çmime të ndryshme siç janë banesa, vetura, apo shuma të parave në vlera të ndryshme, bizneset synojnë nxitjen e klientëve për blerje të vazhdueshme. Edhe pse shumë e shpeshtë viteve të fundit, praktika e këtyre lojërave nuk është e rregulluar nga korniza ligjore në Kosovë, dhe bizneset nuk raportojnë tek asnjë institucion rreth ndarjes së shpërblimeve, metodës së përdorur për përzgjedhjen e fituesve, përfituesve të shpërblimeve, etj.

Deri më 10 maj 2019, organizimi i lojërave shpërblyese rregullohej nga Ligji për lojërat e fatit. Bazuar në këtë ligj, bizneset ishin të detyruara të marrin leje nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) për organizimin e lojërave shpërblyese, e cila po ashtu i ka monitoruar edhe ngjarjet e organizuara për ndarjen e shpërblimeve. Shpërblimet e ndara nga bizneset në atë periudhë nuk mund të tejkalonin shumën një mijë euro. Mirëpo, me shfuqizimin e atij ligji, ku si qëllim i Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës ishte të mbroheshin qytetarët nga dukuria e basteve, lojërave dhe incidenteve nëpër kazino etj., ka mbetur e pa rregulluar edhe pjesa e organizimit të lojërave shpërblyese nga bizneset. Organizimi i lojërave të tilla dhe vlera e shpërblimeve tani është në përgjegjësi të vet bizneseve, pa ndonjë monitorim nga institucionet shtetërore. Për momentin, vetëm njëra nga bizneset e mëdha është duke e zhvilluar një lojë shpërblyese me mbi 150 shpërblime, që kapin vlerën prej mbi 100 mijë euro.

Nga një përlogaritje e Institutit GAP, bazuar në të dhënat e qasshme online, gjatë periudhës 2009–2023 janë identifikuar shpërblime kryesore në vlerë rreth 2.7 milionë euro duke përfshirë banesa, vetura dhe shuma parash. Krahasuar me periudhën kur organizimi i lojërave shpërblyese monitorohej nga ATK, pas vitit 2019 janë premtuar 16 herë më shumë shpërblime për klientë, ku vlera e shpërblimeve të ndara është për 12 herë më e lartë. Sipas analizës, vetëm gjysma (54%) e shpërblimeve kryesore të parapara të ndahen janë bërë transparente për publikun, ku shpërblimet janë ndarë qoftë në evente direkte të transmetuara në televizione nacionale, rrjete sociale, apo duke përdorur ndonjë formulë që bën përzgjedhje të rastësishme të fituesve. Asnjë nga bizneset (organizatorë të lojërave të tilla) të kontaktuar nga GAP me kërkesë për qasje në të dhëna nuk është përgjigjur në lidhje me organizimin e këtyre lojërave.

Një situatë e tillë, me boshllëk ligjor dhe mungesë të transparencës, rritë mundësitë që disa biznese të mos bëjnë shpërndarje të drejtë të shpërblimeve, përdërisa i rrisin fitimet e tyre. Kjo, qoftë duke paguar më pak tatim në fitim, meqë shpenzimet për lojëra shpërblyese janë tërësisht të zbritshme për qëllime tatimore, duke mos regjistruar saktë shpërblimet për qëllime të pagesës së tatimit mbi vlerën e shtuar, por edhe duke përfituar nga rritja e shitjeve për shkak të ndikimit pozitiv që kanë kampanjat për lojëra shpërblyese. Pra, të hyrat tatimore të shtetit ndikohen negativisht në disa aspekte.

Të pa monitoruara mbesin edhe programet e besnikërisë të krijuara nga bizneset, përmes të cilave po ashtu ndahen shpërblime për konsumatorët. Edhe pse këto të fundit paraqesin më pak rrezik krahasuar me lojërat shpërblyese – për shkak se mekanizmat për ndarjen e shpërblimeve dihen paraprakisht dhe edhe vet konsumatorët mund të monitorojnë pikët apo benefitet e grumbulluara të tyre etj. – në periudhën 2021–2023, tek Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit në kuadër të Ministrisë së Industrisë janë dorëzuar 12 ankesa pikërisht rreth programeve të besnikërisë.

Në vendet e Ballkanit Perëndimor, sikurse Shqipëri dhe Maqedoni të Veriut, lojërat shpërblyese janë të rregulluara plotësisht me kornizë ligjore, ku institucionet shtetërore bëjnë monitorimin e lojërave shpërblyese të bizneseve dhe organizatorët paguajnë një tarifë për organizimin e një loje të tillë. Ndërsa, në vendet e Bashkimit Evropian ka një përdorim më të gjerë të programeve të besnikërisë, e kjo rregullohet edhe nga korniza ligjore. Duke marrë parasysh se në Kosovë lojërat shpërblyese dhe programet e besnikërisë nuk kanë ndonjë rregullim, Instituti GAP rekomandon që institucionet publike, të marrin masa për të mënjnuar shfrytëzimin e mungesës së bazës ligjore nga bizneset të cilat organizojnë lojëra shpërblyese; për pagesat e tatimeve më të ulëta apo favorizimin e individëve të caktuar me shpërblime.

# Hyrje

Gjatë blerjeve të zakonshme shpesh rastis të shohim mundësi të ndryshme për t'u bërë pjesë e ndonjë loje shpërblyese. Lojërat shpërblyese janë një mjet i zakonshëm që bizneset në Kosovë përdorin si strategji të marketingut për të rritur shitjet dhe numrin e klientëve. Përmes këtyre lojërave, bizneset premtojnë shpërblime të ndryshme si banesa, vetura, apo shuma të parave në vlera të ndryshme. Për të qenë pjesëmarrës në një lojë të tillë, kryesisht për klientët caktohet një shumë minimale e blerjes së produkteve të caktuara në atë biznes. Megjithatë, klientët shpesh nuk e dinë se çfarë ndodh me shpërblimet e premtuara, nëse ato vërtet ndahen dhe nëse ndarja e shpërblimeve bëhet sipas kriterëve të drejta dhe përmes një procesi transparent.<sup>1</sup>

Mënyrë tjetër e shpërblimit të klientëve është ajo përmes programeve të besnikërisë. Një program i besnikërisë së klientëve është një strategji e marketingut që shpërblen ata që blejnë rregullisht në një markë, duke ofruar përfitime të tilla si pikë, zbritje, apo qasje më të lehtë në produkte ose shërbime.<sup>2</sup> Kjo ndihmon në shtimin e blerjeve dhe thëllon lidhjen e klientëve me markën, duke rezultuar me ruajtjen dhe rritjen e shpenzimeve të tyre. Investimet në këto programe përveç për klientët sjellin përfitime edhe për bizneset, pasi klientët besnikë kanë tendencë të shpenzojnë më shumë. Studimet e ndryshme tregojnë se është të paktën gjashtë herë më e shtrenjtë për bizneset të fitojnë besimin e një klienti të ri sesa të mbajnë një ekzistues.<sup>3</sup> Këto programe aplikohen më shumë në vendet e Bashkimit Evropian dhe vendet tjera më të zhvilluara, ndërsa viteve të fundit kanë filluar të bëhen më të shpeshta edhe në Kosovë. Për dallim nga lojërat shpërblyese, programet e besnikërisë klientët i shpërblejnë brenda një kohe më të shkurtër, ose përmes zbritjeve në çmime të menjëhershme. Këto programe mund të administrohen nga biznesi, një degë e tij ose një palë e tretë. Këto programe po ashtu nuk monitorohen nga ndonjë institucion në Kosovë.<sup>4</sup> Ndonëse mekanizmat përmes të cilave ndahen shpërblimet në këto programe janë më transparente, dhe qytetarët mund ta monitorojnë vet procesin e grumbullimit të pikëve apo benefiteve, gjithsesi ekziston hapësirë për parregullsi. Për çka, qytetarët edhe kanë dorëzuar ankesa në institucionet gjegjëse, siç tregojnë gjetjet nga seksionet në vijim.

Niveli në rritje i inflacionit, kërkesa për komoditet dhe shpejtësi, ndryshimi i zakoneve të blerjeve, ofrimi i platformave të ndryshme për shitje/blerje online, janë sfidat më të shpeshta me të cilat hasin bizneset pas pandemisë COVID-19.<sup>5</sup> Si mënyrë për t'i adresuar këto sfida, bizneset në Evropë kanë parë shpërblimin e klientëve të tyre përmes programeve të ndryshme të besnikërisë (ang. gamification of purchases).<sup>6</sup>

Në këtë raport, Instituti GAP ka analizuar kornizën ligjore dhe ka bërë llogaritjen e përafërt të shpenzimeve për shpërblime të këtyre lojërave në Kosovë. Të dhënat janë marrë përmes të dhënave dytësore, përfshirë këtu vetëm të dhëna të qasshme online nga publikimet e organizatorëve të këtyre lojërave nga viti 2009 deri në vitin 2023. Këto të fundit jo domosdoshmërisht përfshijnë të gjitha lojërat shpërblyese të organizuara në Kosovë. Në përllogaritje janë përfshirë vetëm shpërblimet kryesore që janë premtuar nga bizneset, të tilla si banesa, vetura apo vlera në para të gatshme mbi 10 mijë euro. Llogaritja e çmimeve të shpërblimeve është bazuar në llojin e shpërblimit dhe në çmimin mesatar të tregut për shpërblim, qoftë banesë apo veturë. Çmimi i banesave është llogaritur me një mesatare prej 50 mijë euro duke qenë se nuk dihet madhësia e banesave apo lokacioni, kurse veturat janë llogaritur bazuar në çmimin e veturës për atë vit kur është premtuar. Për të siguruar këto

1 Radio Televizioni i Kosovës (RTK). [Lojërat shpërblyese, pa bazë ligjore dhe pa kontroll](#). Qasur së fundmi me 20 janar 2024.

2 Sales Force. Customer Loyalty Programs: What Are They? (With Examples). [Why is a customer loyalty program such a key marketing strategy? Here's what you need to know](#). Qasur së fundmi më 23 janar 2024.

3 Ibid.

4 Fokusi primar në këtë raport mbetet tek lojërat shpërblyese.

5 The Octalysis Group. [Supermarkets can use gamification to combat Inflation](#). Qasur së fundmi më 23 janar 2024.

6 Ibid.

të dhëna, Instituti GAP së pari ka kontaktuar mbi 12 biznese<sup>7</sup> të njohura në publik për organizimin e shpesh të lojërave të tilla, mirëpo asnjë nga këto biznese nuk është përgjigjur në pyetësor. Gjithashtu raporti krahason praktikat vendore me ato ndërkombëtare, përfshirë Bashkimin Evropian (BE), si Italinë e Zvicrën, dhe shtetet e Ballkanit Perëndimor si Maqedonia e Veriut dhe Serbia.

## (Mos)kontrolli i lojërave shpërblyese në Kosovë

Ka më shumë se katër vite që shteti i Kosovës nuk ka kontroll mbi veprimtarinë e lojërave shpërblyese, për të cilën, sa ka qenë Ligji për lojërat e fatit në fuqi, monitorimin e ka kryer Administrata Tatimore e Kosovës (ATK). Ligji për lojërat e fatit<sup>8</sup>, është shfuqizuar nga Ligji për ndalimin e lojërave të fatit.<sup>9</sup> Deri më 10 maj 2019, bazuar në Ligjin e shfuqizuar për lojërat e fatit, bizneset për organizimin e lojërave shpërblyese kanë qenë të detyruar të marrin leje nga Administrata Tatimore e Kosovës. Ndërsa pas kësaj date, sipas një njoftimi të bërë në faqen zyrtare të ATK-së, organizimi i lojërave të tilla mbetet në përgjegjësi të vetë bizneseve, pa ndonjë monitorim nga institucionet shtetërore. Qeveria e asaj kohe mori vendim për të shfuqizuar Ligjin për lojërat e fatit, i cili u materializua më pas me votimin e projektligjit të ri nga shumica në Kuvend, me qëllim të mbrojtjes së qytetarëve nga dukuritë e dëmshme si bastet, lojërat e fatit dhe ngjarjet e tjera në kazino dhe të ngjashme.

Sipas Ligjit të shfuqizuar për lojërat e fatit, konkurset dhe lojërat shpërblyese nuk ishin lojëra të fatit dhe mund të organizoheshin me kusht që pjesëmarrja në lojë të mos inkasohet.<sup>10</sup> Në Ligjin e shfuqizuar, shpërblimet nga konkurset shpërblyese lejohej të jepeshin në produkte, shërbime ose edhe në para të gatshme, por pa tejkalar shumë një mijë euro.

Bizneseve nuk u kërkohet të paguanin ndonjë taksë shtesë në rastin e organizimit të lojërave shpërblyese; kjo ngase këto shpenzime llogariteshin tërësisht si shpenzime të përfaqësimit (reklamës/promocionit). Edhe pse lojërat shpërblyese nuk përmenden specifikisht në kornizën ligjore, bizneset mund të referohen në Ligjin për tatimin mbi të ardhurat e korporatave për shpenzime të tilla. Sipas këtij Ligji, shpenzimet e reklamës dhe promocionit janë shpenzime të zbritshme për qëllime tatimore.<sup>11</sup>

Në mungesë të kontrollit mbi praktikën e lojërave shpërblyese, në Kosovë është krijuar një boshllëk ligjor i cili mund të shfrytëzohet në formë jo të duhur nga bizneset. Nëse disa biznese i ndajnë shpërblimet në formë selektive dhe jo bazuar në metoda që garantojnë përzgjedhje të rastësishme apo me gjasa të njëjta të fituesve, ato po ashtu përfitojnë padrejtësisht edhe nga ulja e obligimeve tatimore ndaj shtetit. Kjo pasi që shpenzimet për lojëra shpërblyese janë tërësisht të zbritshme, si shpenzime marketingu, me ç'rast zvogëlohet hendeku mes të hyrave dhe shpenzime vjetore të atyre bizneseve, dhe rrjedhimisht tatimi në fitim që duhet të paguajnë të njëjtat. Njëkohësisht, kampanjat e zhvilluara të lojërave shpërblyese ndikojnë pozitivisht në rritjen e shitjeve të atyre bizneseve.

Ngjashëm, për disa nga shpërblimet që bizneset parashohin t'i ndajnë gjatë këtyre lojërave, sikurse veturat, ato janë të obliguara të paguajnë tatim mbi vlerën e shtuar (TVSh). Mirëpo, si pasojë e mos monitorimit direkt nga ATK në këto aktivitete, ka raste kur veturat apo komoditetet tjera që më vonë ndahen si shpërblime, fillimisht

7 Interex, Albi Group, Devolli Corporation, Viva Fresh Sh.p.k, Meridian Corporation, Superviva, Jora Center, Ipko, Elkos Group, Nimi tv, Kastrati Group, Banka Ekonomike.

8 Kuvendi i Republikës së Kosovës. [Ligji Nr. 04/L-080 për lojërat e fatit](#). Qasur së fundmi më 10 janar 2024.

9 Kuvendi i Republikës së Kosovës. [Ligji Nr. 06/L-155 për ndalimin e lojërave të fatit](#). Qasur së fundmi më 12 shkurt 2024.

10 Ibid. "Konkurset shpërblyese dhe lojërat e shpërblyese që i organizon subjekti juridik me qëllim propagandistik nuk janë lojëra të fatit në pajtim me këtë ligj dhe të njëjtat, mund të organizohen me kusht që pjesëmarrja në lojë të mos inkasohet, veçanërisht që shpërblimi të paguhet në prodhime apo shërbime dhe që rregullat e lojës në bazë të lejës së Ministrisë për Ekonomi dhe Financa të shpallen në shtypin ditor."

11 Kuvendi i Republikës së Kosovës. [Ligji nr. 05/L-029 për tatimin në të ardhurat e korporatave](#), neni 11. Qasur së fundmi më 5 dhjetor 2023.

blehen si asete të kompanisë për shfrytëzim për qëllime të biznesit.<sup>12</sup> Kjo pasi që sipas Ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe bazës ligjore plotësuese, veturat e përdorura për qëllime biznesore lirohen nga TVSh.<sup>13</sup>


Për shkak të mos monitorimit të këtyre lojërave, ATK e ka të vështirë që t'i identifikojë edhe fituesit, të cilët po ashtu janë të obliguar të paguajnë tatim për të ardhurat apo shpërblimet e fituara.<sup>14</sup> Rrjedhimisht, të ardhurat e shtetit ndikohen negativisht në disa aspekte nga ky boshllëk ligjor.

## Lojërat shpërblyese në Kosovë: llogaritjet e shpërblimeve

Nga një përlllogaritje e Institutit GAP, bazuar në të dhënat e qasshme online, gjatë periudhës 2009–2023 janë premtuar shpërblime kryesore në vlerë rreth 2.7 milionë euro duke përfshirë banesa, vetura dhe shuma parash. Krahasuar me periudhën kur organizimi i lojërave shpërblyese monitorohej nga ATK, pas vitit 2019 janë premtuar 16 herë më shumë shpërblime për klientë, në një vlerë të shumëfishuar për 12 herë. Nga këto të dhënat e qasshme online janë identifikuar 26 banesa në vlerë prej 1.3 milionë euro,<sup>15</sup> 56 vetura në vlerë prej 1.2 milion euro dhe 12 shpërblime në para të gatshme në vlerë prej 132 mijë euro. Për momentin, vetëm njëra nga bizneset e mëdha është duke e zhvilluar një lojë shpërblyese më mbi 150 shpërblime, që kapin vlerën prej mbi 100 mijë euro.

Ndër shpërblimet e premtuara nga bizneset për klientët e tyre ka vetura nga brende të ndryshme si Range Rover, BMW, Volkswagen dhe Renault, mes tjerash. Instituti GAP ka hasur edhe në shpërblime tjera si telefona në vlerë mbi një mijë euro, shuma të ndryshme parash, televizora, skutera, pajisje të ndryshme elektronike mes produkteve tjera, mirëpo këto të fundit nuk janë përfshirë në llogaritje pasi që nuk e kalojnë vlerën mbi 10 mijë euro për njësi.

**Figura 1.** Numri dhe vlera e gjithsej shpërblimeve (2009–2023)



Burimi: Instituti GAP duke u bazuar në të dhëna online të bizneseve

<sup>12</sup> Nga komunikimi dhe diskutimet me njohës të lojërave shpërblyese në Kosovë.


<sup>13</sup> Ministria e Financave. [Udhëzimi administrativ mf- nr. 03/ 2015 për zbatimin e ligjit nr. 05/I-037 për tatimin mbi vlerën e shtuar](#). Neni 56.4. Qasur së fundmi më 25 mars 2024.

<sup>14</sup> [Liqji nr. 05/I -028 për tatimin në të ardhurat personale](#). Neni 14. Qasur së fundmi më 25 mars 2024.

<sup>15</sup> Shënim: Vlera e apartamenteve të banimit është llogaritur në një mesatare nga tregu i patundshmërive prej 50,000 euro.

Nga të dhënat e analizuara, nga viti 2009 deri në maj 2019 janë organizuar më pak lojëra shpërblyese, ndërsa nga viti 2019 deri në vitin 2023, lojërat shpërblyese kanë qenë shumë më të shpeshta (përfshirë këtu bën viti 2020). Kjo mund të jetë gjithashtu si pasojë e shfuqizimit të ligjit dhe përdorimit më të gjerë të internetit dhe të rrjeteve sociale në vitet e fundit, gjë e cila e bën shpërndarjen e informacionit shumë më të lehtë. Periudha 2009–2018 përfshinë lojërat e organizuara në vitet 2009, 2016, 2017 dhe 2018. Analiza përfshinë vitin 2009 pasi që është viti i parë i identifikuar me një lojë shpërblyese e cila si shpërblim kryesor ka pasur një veturë. Ndërsa pas vitit 2009 deri në vitin 2016 nuk hasim në lojëra shpërblyese me shpërblime në vlerë mbi 10 mijë euro, të paktën nga informacioni i qasshëm online.


**Figura 2.** Vlera e shpërblimeve para dhe pas shfuqizimit të Ligjit për lojërat e fatit (2009–2023)



Burimi: Instituti GAP duke u bazuar në të dhëna online të bizneseve

Shpërblime me gjithsej vlerë më të madhe janë premtuar gjatë vitit 2019; më konkretisht, janë premtuar 15 banesa në vlerë gjithsej rreth 750 mijë euro. Një vit më vonë, në vitin 2020, gjatë kohës kur vendi përballej me pasojat ekonomike të pandemisë COVID-19, shpërblimet kryesisht përbënin shuma parash në vlerë më pak se 10,000 euro, edhe pse të shumta në numër. Në vitin 2022, janë organizuar lojëra shpërblyese me gjithsej vlerë më të madhe, mbi 626 mijë euro; ku 48% e kësaj vlere është ndarë për banesa, 36% për vetura dhe pjesa tjetër në shuma të parave. Ndikim në organizimin më të madh të lojërave shpërblyese nga viti 2019 mund të ketë edhe lehtësimi dhe heqja e aprovimit paraprak nga ATK. Duke marrë parasysh që nga viti 2019 bizneset janë të lira të operojnë në formën që ato vendosin të organizojnë lojën shpërblyese,<sup>16</sup> shumica e bizneseve në formë legjitime vendosin që ndarjen e shpërblimeve të mos e bëjnë publike.

**Figura 3.** Vlera e shpërblimeve sipas viteve (2016–2023)



Burimi: Instituti GAP duke u bazuar në të dhëna online të bizneseve

<sup>16</sup> Administrata Tatimore e Kosovës. Njoftim për tatimpagues – [ATK, nuk miraton organizimin e lojërave shpërblyese](#). Qasur së fundmi me 24 janar 2024.

Nga analiza e gjithë lojërave të paraqitura në raport (2009–2023), ka rezultuar që më shumë se gjysma e shpërblimeve kryesore (54%) të parapara të ndahen janë bërë transparente për publikun. Në këto 54% të rasteve, bizneset kanë bërë publike tërheqjen e emrit të fituesit/es të shpërblimeve përmes kuponave, qoftë në evente direkte të transmetuara në televizione nacionale apo rrjete sociale, apo duke përdorur ndonjë formulë që bën përzgjedhje të rastësishme të fituesve. Kjo praktikë rritë besimin e pjesëmarrësve të lojës. Përkundër mungesës së transparencës në dhënien e shpërblimeve, konsumatorët nuk i adresojnë pakënaqësitë apo dyshimet e tyre. Sipas Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorit në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, nga viti 2013 kur ky departament ka filluar të pranojë ankesa, janë pranuar gjithsej 12 ankesa për pikë besnikërie dhe vetëm një ankesë për lojë shpërblyese.<sup>17</sup> Ankesa e parë është pranuar në vitin 2021, gjashtë ankesa janë pranuar në vitin 2022 dhe të tjerat në vitin 2023.

## Praktikat e shpërblimit të klientëve në vendet e Bashkimit Evropian dhe Ballkanit Perëndimor

Në vendet e Bashkimit Evropian, bizneset ofrojnë shpërblime dhe avantazhe për klientët kryesisht përmes programeve të besnikërisë, por jo domosdoshmërisht përmes lojërave shpërblyese. Mbi 61% e klientëve në Evropë janë pjesë e këtyre programeve, duke shkuar në mbi 80% në vende si Norvegjia dhe Suedia. Edhe në vende me pjesëmarrje më të ulët, si Turqia dhe Rumania, anëtarësia në programet e besnikërisë mbetet mbi 30%.<sup>18</sup> Një nga mënyrat më të zakonshme të shpërblimit është përmes kartelave të besnikërisë, ku konsumatorët marrin pikë për çdo blerje dhe mund t'i shfrytëzojnë ato për zbritje në blerjet e ardhshme, praktikë që rritë besnikërinë e klientëve. Gjithashtu, pjesë e strategjive të bizneseve për të tërhequr klientë janë edhe ofertat e veçanta dhe zbritjet për produkte të caktuara. Katalogët dhe njoftimet e tyre periodike njoftojnë klientët për ofertat aktuale dhe mundësi për të kursyer. Këto programe të besnikërisë në vendet e BE-së obligohen të zbatohen në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave (GDPR)<sup>19</sup>, e cila ka nisur të zbatohet që nga data 25 maj 2018. Ky akt ligjor përcakton një sërë detyrimesh për mbrojtjen e privatësisë dhe përdorimin e të dhënave personale, duke kërkuar respektimin e rregullave dhe marrjen e miratimit për përpunimin e tyre.<sup>20</sup>

Në Itali, programet e besnikërisë rregullohen nga Autoriteti Italian i Konkurrencës (Autorità Garante della Concorrenza e del Mercato), i cili siguron praktika të drejta dhe transparente, mbron të drejtat e klientëve dhe parandalon pastrimin e parave.<sup>21</sup> Për të organizuar një program besnikërie, bizneset paguajnë vetëm taksa mbi vlerën e shpërblimeve që u japin klientëve të tyre.<sup>22</sup> Shpërblimet konsiderohen si furnizime të tatueshme të mallrave ose shërbimeve dhe i nënshtrohen TVSh-së sipas normës së aplikueshme. Në Itali, programet e besnikërisë konsiderohen si shpenzime marketingu për bizneset dhe ato mund t'i zbresin deri në një përqindje të caktuar nga të ardhurat e tyre të tatueshme. Më saktësisht, zbritja është e kufizuar në 10% të totalit të shpenzimeve të

17 Korrespondencë mes Institutit GAP dhe Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorit në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, dhjetor 2023.

18 Mando Connect. [Understanding the Loyalty Landscape in Europe White Paper](#). Qasur së fundmi më 24 janar 2024.

19 [General Data Protection Regulation](#). Neni 26. Qasur së fundmi më 23 janar 2024.

20 OCI- General Data Protection. [Protecting Personal Data](#). Qasur së fundmi më 24 janar 2024.

21 Researchandmarkets. [Italy Loyalty Programs Market Intelligence and Future Growth Dynamics Databook](#), 2024. Qasur së fundmi më 13 shkurt 2024.

22 Agenzia Entrate, Ministry of Finance and Economy. [VAT in Italy](#). Qasur së fundmi më 13 shkurt 2024.



marketingut dhe nuk mund të kalojë 2% të fitimit vjetor.<sup>23</sup> Ndërsa, kur bizneset organiojnë lojëra fati, si lotari apo baste, paguajnë një normë të veçantë tatimore, e cila ndryshon në varësi të llojit dhe vlerës së shpërblimit.

Në rastin e Zvicrës, shpërblimi i klientëve është rregulluar përmes programeve të besnikërisë, ku bizneset duhet të kalojnë nëpër aspekte të ndryshme ligjore për të siguruar praktika të drejta dhe transparente. Programet e besnikërisë rregullohen kryesisht nga ligjet për mbrojtjen e konsumatorit, ligji i kontratave dhe rregulloret për mbrojtjen e të dhënave. Këto programe kategorizohen si shpenzime të marketingut dhe hyjnë në kategorinë e shpenzimeve me TVSh të zbritshme pasi që përdoren për arsye të zhvillimit të biznesit. Në shumicën e rasteve, lojtarët dhe operatorët e këtyre lojërave janë nën mbikqyrjen dhe autorizimin e autoriteteve të rregullatorit, siç është Bordi Federal i Lojërave të Parave në Zvicër. Ndërsa, korniza ligjore përfshin lojërat e fatit si pjesë e rregullimit të lojërave të basteve. Lojërat e fatit përfshijnë çdo aktivitet ku pjesëmarrësit vendosin një sasi të caktuar të parave ose vlerë të njohur për mundësinë e fitimit të një shpërblimi ose fitimi tjetër monetar. Rregullorja specifikon një numër të madh të rregullave dhe kufizimeve për lojërat e fatit, duke përfshirë obligimet e organizatorëve të lojërave lidhur me përgjegjësitë shoqërore, masat kundër pastrimit të parave, dhe kufizimet e reklamave dhe promocionit. Ligjet dhe rregulloret për lojërat e fatit kufizohen vetëm në rregullimin e lojërave të basteve, por jo edhe tek programet e besnikërisë, përveç nëse programet e besnikërisë së klientëve aplikohen nga organizuesit e këtyre lojërave.<sup>24</sup>

Në Maqedoninë e Veriut, shpërblimi i klientëve në lojërat e fatit dhe lojërat argëtuese është rregulluar nëpërmjet Ligjit për lojëra të fatit dhe lojëra argëtuese.<sup>25</sup> Disa nga pikat kyçe të këtij ligji janë definicionet e lojërave, llojet e lojërave dhe procedurat ligjore për organizuesit. Në rastin e lojërave argëtuese, organizator mund të jetë edhe një person fizik-tregtar individual, pasi të licencohet nga Ministria e Financave.<sup>26</sup> Lojëra shpërblyese janë lojërat e fatit të cilat i organizon një ose më shumë biznese për qëllim të reklamimit të produkteve dhe shërbimeve.<sup>27</sup> Këto lojëra organizohen në mënyra të ndryshme si elektronike, nëpërmjet telefonatave, internetit, shpalljeve publike. Organizatorët detyrohen që fituesve të ju ndajnë shpërblimet në produkte apo shërbime, shuma të parave ose të drejta, varësisht çfarë kanë paraparë si shpërblim. Tarifa për organizimin e lojërave është 18% e vlerës së fondit shpërblyes, e paguar para organizimit të lojërave.<sup>28</sup> Nëse disa shoqëri paraqiten bashkërisht si organizatorë të lojës shpërblyese, tarifa ndahet ndërmjet organizatorëve në masë të barabartë përmes marrëveshjes paraprake. Kushtet e lojërave duhet të bëhen publike në gazeta lokale, dhe rezultatet e fituesve duhet të shpallen brenda tre ditëve. Kohëzgjatja e lojërave nuk mund të jetë më shumë se një vit.<sup>29</sup> Ligji përcakton se për çdo çështje që nuk është e paraparë, zbatohet Ligji për procedurë të përgjithshme administrative.<sup>30</sup> Përveç kësaj, nga viti 2023 përfituesit nga lojërat shpërblyese në Maqedoninë e Veriut duhet të paguajnë 15% tatim mbi të ardhurat nga këto lojëra.<sup>31</sup>

23 Ibid.

24 ICLG – [Gambling Laws and Regulations](#). Qasur së fundmi me 24 janar 2024.

25 Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. [Ligji për lojërat e fatit dhe lojërat argëtuese](#). Qasur së fundmi më 17 Janar 2024.

26 Ibid.

27 Ibid.

28 Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. [Ligji për lojërat e fatit dhe lojërat argëtuese](#). Neni 129. Qasur së fundmi më 23 janar 2024

29 Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. [Ligji për lojërat e fatit dhe lojërat argëtuese](#). Neni 126. Qasur së fundmi më 23 janar 2024.

30 Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. [Ligji për lojërat e fatit dhe lojërat argëtuese](#). Qasur së fundmi më 23 janar 2024.

31 Telegrafi. [Ligji i ri i tatimeve në Maqedoni, parasheh rritje tatimore në disa veprimtari](#), 2023. Qasur së fundmi më 23 janar 2024.

Në Serbi, nuk ka ligje specifike të dedikuara vetëm për programet e besnikërisë, mirëpo bizneset prapë duhet të kalojnë nëpër aspekte të ndryshme ligjore për të siguruar praktika të drejta dhe transparente. Kjo, ngase Serbia i ka ligjërish të lejuara lojërat e fatit.<sup>32</sup> Bizneset serbe mund të krijojnë programe besnikërie pa një tarifë të detyrueshme, mirëpo, ato duhet të respektojnë ligjet për mbrojtjen e konsumatorit, rregulloret e privatësisë dhe udhëzimet e reklamimit/marketingut. Shpenzimet e marketingut në shtetin e Serbisë konsiderohen si pjesë e operacioneve të rregullta të një biznesi dhe i nënshtrohen normës standarde të tatimit, përveç nëse zbatohen përjashtime ose rregulla specifike. Ndryshe nga vendet e tjera, në Serbi ekziston një uebfaqe, edhe pse jo zyrtare, në të cilën postohen të gjitha lojërat shpërblyese aktive, ku edhe tregohen fituesit/et e shpërblimeve.<sup>33</sup>

Në Shqipëri, lojërat shpërblyese (promocionale) rregullohen nga Ligji për lojërat e fatit.<sup>34</sup> Sipas këtij ligji, "Lojë fati promocionale" është loja, që promovon produkte ose shërbime, në të cilën pjesëmarrësit mund të konkurrojnë për çmime apo bonuse. Në këto raste, Ministri i Financave në Shqipëri u jep autorizim subjekteve publike ose private, për të organizuar lojëra fati promocionale, nëpërmjet shitjes dhe tregtimit të mallrave apo në ndonjë mënyrë tjetër gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, për efekt promovimi ose publiciteti të mallit. Mënyrat, format, kriteret dhe rregullat shtesë për organizimin e lojërave të fatit promocionale përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.<sup>35</sup> Këto lojëra më pas mbikëqyren dhe kontrollohen nga Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit.<sup>36</sup> Sipas një prej vendimeve të Këshillit të Ministrave, Lojërat e fatit promocionale mund të organizohen nga organizatorët duke ofruar falas produktin/shërbimin që do të promovohet, duke ofruar produktin/shërbimin me çmimin e shitjes bashkë me një kupon, një biletë, mundësinë për të gërvishur në ambalazhin e produktit të blerë, apo çdo mënyrë tjetër, të parashikuar nga organizatori, por pa kosto të tjera shtesë për klientin.<sup>37</sup> Për marrjen e autorizimit, organizatorët e lojërave promocionale të fatit duhet të paguajnë paraprakisht tarifën prej 200 mijë lekë (1,939 euro).<sup>38</sup> Këto të ardhura derdhen 100% në buxhetin e shtetit të Shqipërisë.<sup>39</sup> Për sa i përket detyrimeve të përfituesëve nga këto lojëra, sipas udhëzimit të përgjithshëm për tatimin mbi të ardhurat, të ardhurat nga dhuratat, trashëgimitë dhe lojërat e fatit të përfituara në Republikën e Shqipërisë nga rezidentët dhe jorezidentët, tatohen me normën 15% pa zbritur ndonjë kosto të tyre.<sup>40</sup>

Në Malin e Zi shpërblimet për klient kryesisht aplikohen përmes programeve të besnikërisë, të cilat nuk rregullohen ligjërish. Ndërsa Ligji për Lojërat e Fatit rregullon aktivitetet e lojërave të fatit si lotaritë, bastet dhe bingo, për të cilat nevojitet licenca.<sup>41</sup>

32 Kuvendi i Republikës së Serbisë. [Ligji për lojërat e fatit](#). Qasur së fundmi më 12 shkurt 2024.

33 [NagradneigreRS.com](#)

34 Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë. [Ligji Nr. 155/2015 për lojërat e fatit në republikën e Shqipërisë](#) (ndryshuar me ligjin nr. 140/2016, datë 22.12.2016, nr. 75/2018, datë 25.10.2018. Qasur së fundmi më 20 mars 2024.

35 Ibid.

36 Ibid.

37 Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit. [Vendimi për përcaktimin e mënyrave, formave, kriterëve dhe rregullave për organizimin e lojërave të fatit promocionale](#), në Fletoren Zyrtare Nr.55, me datë 22.03.2017. Qasur së fundmi më 20 mars 2024.

38 Ibid.

39 Ibid.

40 Udhëzimit të përgjithshëm nr. 26, datë 8.9.2023 për tatimin mbi të ardhurat

41 [Ligji dhe praktika e Malit të Zi](#). Qasur së fundmi më 21 mars 2024.

## Përfundime dhe rekomandime

Për të nxitur blerjet dhe rritur pjesëmarrjen e klientëve, bizneset përdorin strategji të ndryshme si zbritje në çmim, lojëra shpërblyese dhe programe të besnikërisë. Megjithatë, kjo dukuri nuk është e rregulluar me kornizë ligjore në Kosovë që nga viti 2019, për dallim nga vitet paraprake kur Administrata Tatimore e kishte kontrollin mbi këtë veprimtari. Ngjashëm me vendet e Bashkimit Evropian, bizneset në Kosovë organizojnë programe të besnikërisë dhe lojëra shpërblyese, mirëpo çka dallon me praktikën në këto vende është ofrimi më i shpeshtë i shpërblimeve si banesa banimi apo vetura. Deri në maj 2019, lojërat shpërblyese janë organizuar më pak, ndërsa nga korriku i vitit 2019 deri në vitin 2023 lojërat shpërblyese janë më të shpeshta, përjashtim këtu bën viti 2020. Ndikim në këtë mund të ketë pasur shfuqizimi i ligjit për lojërat e fatit dhe përdorimi më i gjerë i internetit dhe rrjeteve sociale në vitet e fundit, gjë e cila e bën shpërndarjen e informacionit shumë më të lehtë.

Në disa nga vendet e Ballkanit Perëndimor, si në Maqedoni të Veriut apo Shqipëri, lojërat e tilla shpërblyese janë të rregulluara me kornizë ligjore. Në Maqedoninë e Veriut, për të organizuar një lojë shpërblyese, një biznes duhet të paguajë tarifën për organizimin e lojës shpërblyese, e cila përfshin shumën prej 18% të vlerës së përgjithshme të fondit shpërblyes. Ndërsa në Shqipëri, organizatorët duhet të paguajnë një shumë prej afro 2 mijë euro. Në vendet jashtë Ballkanit Perëndimor, për shpërblimin e klientëve aplikohen programet e besnikërisë. Në këtë kontekst, programet e besnikërisë konsiderohen si shpenzime marketingu për bizneset dhe ato mund të zbriten deri në një përqindje të caktuar nga të ardhurat e tatueshme të bizneseve.

Në krah të mbrojtjes së konsumatorëve, Instituti GAP rekomandon që institucionet publike, siç është ATK, të marrin masa për të mënjanuar shfrytëzimin e mungesës së bazës ligjore nga bizneset të cilat organizojnë lojëra shpërblyese; për pagesat e tatimeve më të ulëta apo favorizimin e individëve të caktuar me shpërblime. Njëkohësisht duhet të monitorohen edhe programet e besnikërisë, për t'u siguruar që të njëjtat bëjnë ndarjen e pikëve dhe benefiteve në mënyrën e duhur. Për të adresuar këtë çështje është me rëndësi që qoftë në kuadër të ligjeve ekzistuese, rregulloreve apo me ndonjë vendim të vendoset një mekanizëm i kontrollit për të specifikuar kushtet, rregullat dhe kufizimet për lojëra shpërblyese, duke përfshirë obligimet e organizatorëve, masat kundër pastrimit të parave, format e raportimit financiar, kufizimet e reklamave dhe promocionit. Të monitorohet mbarëvajtja e lojës, programeve të besnikërisë, si dhe ndarja e shpërblimeve, duke siguruar një proces sa më transparent dhe të përgjegjshëm. Gjithashtu, është shumë më rëndësi të vendosen kufizime mbi shpenzimet se sa një biznes mund të deklarojë shpenzime nga lojërat shpërblyese. Përmes këtyre ndryshimeve dhe zbatimit të mekanizmave të duhur të kontrollit, do të mund të përmirësohej legjitimiteti i këtyre lojërave dhe programeve të besnikërisë, duke siguruar një mjedis më të rregullt dhe të drejtë për të gjithë akterët e përfshirë.

# Shtojcat

## Shtojca 1. Lojërat shpërblyese në Kosovë

Shpërblimi	Çmimi i përafërt për njësi	Njësia	Gjithsej
<a href="#">Veturë</a>	€35,000.00	1	€35,000.00
<a href="#">Veturë</a>	€20,000.00	1	€20,000.00
<a href="#">Veturë</a>	€63,000.00	1	€63,000.00
<a href="#">Veturë</a>	€30,938.00	1	€30,938.00
<a href="#">Veturë</a>	€20,000.00	1	€20,000.00
<a href="#">Banesë</a>	€50,000.00	1	€50,000.00
<a href="#">Banesë</a>	€50,000.00	15	€750,000.00
<a href="#">Veturë</a>	€25,000.00	1	€25,000.00
<a href="#">Veturë</a>	€40,000.00	1	€40,000.00
<a href="#">Veturë</a>	€26,527.00	3	€79,581.00
<a href="#">Veturë</a>	€7,000.00	1	€7,000.00
<a href="#">Banesë</a>	€50,000.00	1	€50,000.00
<a href="#">Banesë</a>	€50,000.00	1	€50,000.00
<a href="#">Veturë</a>	€25,000.00	3	€75,000.00
<a href="#">Veturë</a>	€20,000.00	3	€60,000.00
<a href="#">Banesë</a>	€50,000.00	1	€50,000.00
<a href="#">Para</a>	€100,000.00	1	€100,000.00
<a href="#">Veturë</a>	€16,129.82	1	€16,129.82
<a href="#">Banesë</a>	€50,000.00	1	€50,000.00
<a href="#">Veturë</a>	€25,000.00	3	€75,000.00
<a href="#">Banesë</a>	€50,000.00	1	€50,000.00
<a href="#">Banesë</a>	€50,000.00	1	€50,000.00
<a href="#">Veturë</a>	€15,000.00	5	€75,000.00
<a href="#">Banesë</a>	€50,000.00	1	€50,000.00
<a href="#">Banesë</a>	€50,000.00	1	€50,000.00
<a href="#">Veturë</a>	€20,000.00	3	€60,000.00
<a href="#">Para</a>	€10,000.00	1	€10,000.00
<a href="#">Para</a>	€2,000.00	10	€20,000.00
<a href="#">Veturë</a>	€20,000.00	2	€40,000.00
<a href="#">Veturë</a>	€15,000.00	5	€75,000.00
<a href="#">Veturë</a>	€15,000.00	1	€15,000.00
<a href="#">Veturë</a>	€15,000.00	1	€15,000.00
<a href="#">Veturë</a>	€15,000.00	1	€15,000.00

Shpërblimi	Çmimi i përafërt për njësi	Njësia	Gjithsej
<a href="#">Veturë</a> 	€15,000.00	1	€15,000.00
<a href="#">Veturë</a> 	€8,399.00	1	€8,399.00
<a href="#">Veturë</a> 	€26,527.00	1	€26,527.00
<a href="#">Veturë</a> 	€26,527.00	1	€26,527.00
<a href="#">Veturë</a> 	€20,000.00	1	€20,000.00
<a href="#">Veturë</a> 	€8,909.00	1	€8,909.00
<a href="#">Banesë</a> 	€50,000.00	1	€50,000.00
<a href="#">Para</a> 	€2,000.00	1	€2,000.00
<a href="#">Veturë</a> 	€15,000.00	4	€60,000.00
<a href="#">Banesë</a> 	€50,000.00	1	€50,000.00
<a href="#">Veturë</a> 	€20,000.00	1	€20,000.00
<a href="#">Veturë</a> 	€70,000.00	1	€70,000.00
<a href="#">Veturë</a> 	€20,000.00	3	€60,000.00
<a href="#">Veturë</a> 	€45,000.00	1	€45,000.00
<a href="#">Veturë</a> 	€45,000.00	1	€45,000.00

Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të vitit 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheqë profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të plotësojë zbrazëtitë mes qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të plotësojë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

[www.institutigap.org](http://www.institutigap.org)

Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Nr. 4, 10000 Prishtinë

Tel.: +383 38 609 339

[info@institutigap.org](mailto:info@institutigap.org)

Instituti GAP mbështetet nga:



**Rockefeller  
Brothers Fund**

Philanthropy for an Interdependent World

Ky projekt është mbështetur nga




Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

**Swiss Cooperation Office Kosovo**



Sweden  
**Sverige**



**Funksionimi i lojërave shpërblyese**  
në Kosovë në mungesë të  
kontrollit ligjor